



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura IV
Sesioni pranveror

Mbledhja plenare e Kuvendit
P- 69
Prishtinë, më 5 korrik 2012

PROCESVERBAL

**I MBLEDHJES PLENARE TË KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS, TË
MBAJTUR MË 5 KORRIK 2012**

Mbledhjen e kryesoi kryetari **Jakup KRASNIQI**, ndërsa i ndihmoi nënkryetari **Xhavit HALITI**.

Kryetari i deklaroi të hapura punimet e mbledhjes plenare dhe procedoi me rendin e ditës të përgatitur nga Kryesia e Kuvendit, në marrëveshje me kryetarët e grupeve parlamentare.

Kryetari pas hapjes së mbledhjes plenare, u dëshiroi mirëseardhje dhe i falënderoi për vizitën në Republikën e Kosovës, deputetëve të Parlamentit të Bangladeshit, të cilët ishin prezent në sallën e mbledhjeve plenare.

1. Koha për deklaramë jashtë rendit të ditës

Deklarime jashtë rendit të ditës paraqitën deputetët: Bekim Haxhiu, Rexhep Selimi, Jakup Krasniqi, Armend Zemaj, Donika Kadaj-Bujupi, Petar Miletiq, Ganimete Musliu, Imri Ahmeti, Teuta Haxhiu, Rada Trajkoviq, Sabri Hamiti dhe kryeministri Hashim Thaçi, diskutimet e të cilëve janë dhënë të plota në transkript.

2. Koha për pyetje parlamentare

Deputeti Fikrim Damka parashtrroi pyetje për ministrin Fehmi Mujota, në lidhje me kohën se kur do të fillojë hartimi i testeve për patentë shoferë në gjuhën turke, nga ana e ministrisë që ai drejton.

Ministri Fehmi Mujota iu përgjigj pyetjes së deputetit Fikrim Damka.

Deputetja Alma Lama parashtroi pyetje për ministrin Bajram Rexhepi, në lidhje me, siç tha ajo, mos respektimin e Kushtetutës së Kosovës dhe të ligjeve që rrjedhin prej saj, duke lejuar që më 28 qershor në territorin e Kosovës të futen grupe njerëzish të cilët nxisin dhe provokojnë urrejtje etnike dhe fetare, duke rrezikuar sigurinë e vendit. Ministri Bajram Rexhepi iu përgjigj pyetjes së deputetes Alma Lama.

Në vazhdim të punimeve të Kuvendit, kryetari i njoftoi deputetët se në lidhje me plotësimin e rendit të ditës së mbledhjes së sotme kemi propozimin e GP të PDK-së.

Deputeti Behar Selimi, në emër të GP të PDK-së, propozoi plotësimin e rendit të ditës së mbledhjes së sotme plenare me pikën - **Shqyrtimi i parë i Projektligjit për shfuqizimin e neneve 37, 38 dhe 39 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës.**

Për këtë propozim diskutuan edhe deputetët: Arben Gashi – në emër të Komisionit për Legjislacion, Ismet Beqiri - në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, Visar Ymeri - në emër të Grupit Parlamentar të Lëvizjes “Vetëvendosje”, Ardian Gjini - në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, Myzejene Selmani - në emër të Grupit Parlamentar të Koalicionit Kosova e Re, ndërsa Albert Kinolli - në emër të Grupit Parlamentar “6+”, diskutimet e të cilëve janë dhënë të plota në transkript.

Kryetari e hodhi në votim propozimin e deputetit Behar Selimi, për plotësimin e rendit të ditës së mbledhjes së sotme plenare me pikën - **Shqyrtimi i parë i Projektligjit për shfuqizimin e neneve 37, 38 dhe 39 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës.**

Kryetari konstatoi se Kuvendi e miratoi propozimin e deputetit Behar Selimi për plotësimin e rendit të ditës së mbledhjes së sotme plenare me pikën - **Shqyrtimi i parë i Projektligjit për shfuqizimin e neneve 37, 38 dhe 39 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës.**

Kjo pikë radhitet si pikë numër nëntë e rendit të ditës.

Në vazhdim Kuvendi i zhvilloi punimet me këtë:

R e n d d i t e

3. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mëparshme;
4. Interpelanca e ministrit, Besim Beqaj, sipas kërkesës së Grupit Parlamentar të Lëvizjes Vetëvendosje lidhur me procesin e privatizimit të Shpërndarjes dhe të Furnizimit të KEK-ut;
5. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për mbrojtjen e bimëve;
6. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për regjistrimin e bujqësisë;
7. Shqyrtimi i Propozim-strategjisë Minerare të Republikës së Kosovës për periudhën 2012-2025;
8. Shqyrtimi i Rekomandimit të Komisionit për Mbikëqyrjen e Financave Publike lidhur me Raportin e auditimit të pasqyrave vjetore financiare të Organit Shqyrtues të Prokurimit Publik;
9. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për shfuqizimin e neneve 37, 38 dhe 39 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës.

3. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes plenare, të mbajtur më 28 qershor 2012

Kuvendi e miratoi pa vërejtje procesverbalin e mbledhjes plenare, të mbajtur më 28 qershor 2012.

Deputeti Fatmir Xhelili kërkoi që në transkriptin e mbledhjes së datës 28 qershor 2012, në pikën - Shqyrtimi i parë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit për letërnjoftim, ta përmirësojë fjalën pasaportë me fjalën letërnjoftim.

4. Interpelanca e ministrit Besim Beqaj, sipas kërkesës së Grupit Parlamentar të Lëvizjes Vetëvendosje lidhur me procesin e privatizimit të Shpërndarjes dhe të Furnizimit të KEK-ut

Kryetari i njoftoi deputetët se Grupi parlamentar i Lëvizjes Vetëvendosje, në bazë të nenit 44 të Rregullores së Kuvendit, ka parashtruar kërkesë për të ftuar në interpelancë, ministrin Besim Beqaj, lidhur me procesin e privatizimit të Shpërndarjes dhe të Furnizimit të KEK-ut.

Ai, më tej i njoftoi deputetët për kohëzgjatjen e Interpelancës, prej tri orësh, si dhe për kohën e ndarë për secilin grup parlamentar, në bazë të vendeve që kanë në Kuvend, dhe për deputetët pa grup parlamentar, e cila është përcaktuar në bazë të Rregullores së Kuvendit.

Kryetari e ftoi propozuesin e Interpelancës ta marrë fjalën.

Deputeti, **Visar Ymeri**, në emër të GP të Lëvizjes Vetëvendosje, fillimisht tha se privatizimi i kompanisë kosovare për distribuim dhe furnizim me energji elektrike, duhet të ndalet, sepse vendimi i Qeverisë për privatizim të kësaj ndërmarrje nuk ka logjikë ekonomike dhe se është i dëmshëm në aspektin strategjik.

Në vazhdim, ai konstatoi se qasja në energji elektrike e konsumatorit tonë, vlerësoi të jetë e cenuar pikërisht siç tha ai nga politikat e Qeverisë, të cilat sektorin e energjisë po e dizajnojnë sipas logjikës së tregut dhe profitit privat.

Më pas ai privatizimin e kompanisë kosovare për distribuim dhe furnizim me energji elektrike e vlerësoi si një proces i cili nuk ka legjitimitet institucional, duke e arsyetuar këtë me të dhënë se vendimi i Qeverisë për privatizimin e kompanisë është marrë më 2 tetor 2008, ndërsa kompania është themeluar më 24 gusht 2009.

Më tej deputeti Visar Ymeri u fokusua në aspektet ligjore që e kanë përcjellë këtë proces, duke përmendur çështje krahasimore të ligjit për ndërmarrjet publike dhe të vendimit të Qeverisë, lidhur me këtë çështje. Ai më tutje konstatoi se vendimi i Qeverisë për privatizimin e kësaj ndërmarrje nuk është vendosur as në faqen elektronike të Zyrës së Kryeministrit, faqe elektronike kjo në të cilën pasqyrohen të gjitha vendimet tjera nga mbledhjet e Qeverisë.

Një prej problemeve më të ndjeshme të këtij procesi të privatizimit të kësaj ndërmarrje është edhe çështja e çmimit të saj, nuk ka ndonjë informatë se sa janë vlerësuar asetet e kompanisë, sa ka qenë çmimi i vlerësimit i dorëzuar në Zyrën e Rregullatorit të Energjisë, si pjesë e arsyetimit të kërkesës për rritjen e fundit të çmimit të energjisë, theksoi ai.

Për këtë vlerësim të dorëzuar në Zyrën e Rregullatorit të Energjisë ai përmendi shifrën mbi 60 milionë euro, për të parashtruar pyetjen se si u bë që brenda javëve vlerësimi për kompaninë në fjalë të bjerë në 26.3 milionë euro.

Në fund të fjalës së tij deputeti Visar Ymeri parashtroi edhe dy çështje shtesë që dalin për Qeverinë, në këtë drejtim:

1. Pse Qeveria nuk i bënë publike marrëveshjet të cilat do të nënshkruhen me rastin e privatizimit,
2. Si do të rregullohet pastaj çështja e importit të rrymës elektrike.

Diskutimi i plotë i deputetit, **Visar Ymeri** është dhënë në transkript.

Ministri, **Besim Beqaj**, tha se Qeveria e Kosovës është e përkushtuar për zhvillimin e sektorit energjetik, sektor ky i cili duhet t'i zbatojë tri synime themelore: furnizimi i rregullt me energji elektrike, prodhim i energjisë me kosto të përballueshme për qytetarët dhe zbatimin e standardeve ndërkombëtare në fushën e mbrojtjes së mjedisit.

Në vazhdim ai përmendi parimet bazë të cilat e kanë përcjellë këtë proces, të cilat janë: transparenca, konkurrenca, trajtimi i barabartë, diskutimi i hapur me të gjithë faktorët vendorë dhe ndërkombëtarë, profesionalizmi, ruajtja e interesit të punëtorëve, investimet afatgjate, eliminimi i garancioneve shtetërore, eliminimi i subvencionimit për mos inkasim, reduktimi i humbjeve komerciale dhe teknike etj.

Më tej ministri tha se procesi është vazhduar mbi bazë të vendimeve të Kuvendit të Kosovës dhe në harmoni me Kushtetutën e Republikës së Kosovës, me Ligjin për ndërmarrjet publike, me Ligjin për partneritet publiko privat, në harmoni me Strategjinë e Republikës së Kosovës për Energji e cila është aprovuar në Kuvend, vendimin e Kuvendit nr. 03/5-074 dhe në harmoni me Kornizën Afatmesme të Shpenzimeve.

Më pas ai u fokusua në strukturën dhe mekanizmat e këtij procesi, siç janë: Komisioni Qeveritar të Privatizimit, Grupit Qeveritar Teknik dhe Këshilltari i Transaksionit, si dhe në procedurat parakualifikuese dhe kualifikuese të procesit të privatizimit të kësaj ndërmarrje.

Në funksion të transparencës të këtij procesi, ministri përmendi themelimin dhe funksionimin e dy dhomave, siç janë: dhoma fizike e të dhënave, e cila ka qenë e vendosur në distribucionin e KEK-ut dhe dhoma virtuale e të dhënave, përmes të cilave kanë mundur të marrin informata të detajuara të gjithë aktorët e interesuar.

Në fund të fjalës së tij, ministri Besim Beqaj, tha se dy ofertat të cilat i kanë marrë lidhur me privatizimin e kësaj ndërmarrje janë Konzorciumi Çalik-Limak, në shumën 26.3 milionë euro dhe kompania El Sewedy në shumën prej 22.8 milionë euro.

Qeveria ka marrë vendim për shpalljen e Konzorciumit Çalik-Limak fitues i preferuar i procesit të privatizimit të distribucionit.

Ajo që duhet të kuptohet është se Komisioni Ministror dhe as Qeveria nuk ka pasur mandat për të diskutuar për çmimin e privatizimit të kësaj ndërmarrje, por Zyra e Rregullatorit të Energjisë është kompetente për rregullimin e këtyre aspekteve të cilat parashihen në Ligjin për Zyrën e Rregullatorit të Energjisë, në Ligjin për energji dhe në Ligjin për energji elektrike.

Diskutimi i plotë i ministrit **Besim Beqaj** është dhënë në transkript.

Kryesuesi Xhavit Haliti hapi diskutimin lidhur me Interpelancën me ministrin Besim Beqaj.

Zenun Pajaziti, në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, tha se grupi që ai përfaqëson mbështet në mënyrë të plotë Qeverinë e Kosovës për përmbylljen e suksesshme të procesit të privatizimit të kësaj ndërmarrjeje, duke shprehur bindjen e plotë se reformat në sektorin e energjisë do të rezultojnë të favorshme për zhvillimin ekonomik të vendit.

Diskutimi i plotë i deputetit **Zenun Pajaziti** është dhënë në transkript

Teuta Sahatqija, në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, tha se vendimi i Qeverisë për shitjen e këtij aseti shtetëror për vetëm 26.3 milionë euro, është nënçmues dhe është jashtë logjikës së shëndoshë ekonomike.

Më pas deputetja Teuta Sahatqija, në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, para deputetëve lexoi tekstin e mocionit lidhur me procesin e privatizimit të Shpërndarjes dhe të Furnizimit të KEK-ut. Ajo kërkoi që mocioni i GP të LDK-së t'u shpërndahet deputetëve.

Më pas mocioni i GP të LDK-së iu shpërnda deputetëve.

Diskutimi i plotë i deputetes **Teuta Sahatqija** është dhënë në transkript.

Florin Krasniqi, në emër të Grupit Parlamentar “Vetëvendosje”, fillimisht parashtrori disa dilema në formë pyetje rreth procesit të privatizimit të kësaj ndërmarrje: çka do të shitet, kur do të shitet, pse do të shitet, si do të shitet dhe kujt do t’i shitet kjo ndërmarrje.

Në vazhdim, ai u fokusua në përgjigje dhe vizionin e grupit parlamentar që ai përfaqëson rreth këtyre çështjeve.

Më pas deputeti Krasniqi ftoi kompaninë Konzorciumin Çalik-Limak që të tërhiqet nga ky tenderim.

Diskutimi i plotë i deputetit **Florin Krasniqi** është dhënë në transkript

Ardian Gjini, në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, tha se procesi i privatizimit të kësaj ndërmarrjeje nuk ka qenë transparent ndaj Kuvendit dhe qytetarëve të Kosovës, duke shpjeguar këtë se Kuvendi i Kosovës nuk është mjaft i njoftuar lidhur me aspekte të privatizimit dhe të gjendjes së aseteve publike.

Në vazhdim ai konstatoi se procesi i privatizimit të kësaj ndërmarrjeje është i dëmshëm për Kosovën dhe grupi që ai përfaqëson angazhohet që vendi dhe qytetarët e saj, të përfitojnë nga ky proces.

Diskutimi i plotë i deputetit **Ardian Gjini** është dhënë në transkript.

Myzejene Selmani, në emër të Grupit Parlamentar Kosova e Re, tha se Qeveria e Kosovës ka pasur bazë ligjore për t’i hyrë procesit të privatizimit të kësaj ndërmarrjeje, duke e arsyetuar këtë me Ligjin për ndërmarrjet publike, me Ligjin për partneritet publiko- privat dhe me Strategjinë e Energjisë.

Ajo më tutje kërkoi nga kabineti qeveritar që procesi i privatizimit të distribucionit dhe furnizimit të bëhet paralel me ndërtimin e termocentralit Kosova e Re, të bëhet riparimi i termocentralit Kosova B me investime të partneritetit publiko-privat ndaras nga “Kosova e Re”, dhe të realizohet projekti i linjës 400kV me Shqipërinë.

Diskutimi i plotë i deputetes **Myzejene Selmani** është dhënë në transkripto.

Për këtë pikë të rendit të ditës diskutuan edhe deputetët: Halit Krasniqi, Hykmete Bajrami, kryeministri Hashim Thaçi, Sabri Hamiti, Idriz Vehapi, Albin Kurti, Donika Kadaj-Bujupi, Muhamet Mustafa, Myfera Shinik, Sala Berisha-Shala, Teuta Haxhiu, Haki Demolli, Shaip Muja, Visar Ymeri, Blerta Deliu-Kodra dhe ministri Besim Beqaj.

Diskutimet e plota të përfaqësuesve të grupeve parlamentare, të deputetëve dhe të ministrit Besim Beqaj janë dhënë në transkript, që është pjesë përbërëse e këtij procesverballi.

Deputetja Safete Hadergjonaj diskutimin e saj e dorëzoi me shkrim.

Në lidhje me procedimin e mëtejme të tekstit të mocionit të paraqitur nga GP i Lëvizjes Vetëvendosje dhe nga GP i LDK-së, lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, kryetari kërkoi që grupet parlamentare t’i harmonizojnë qëndrimet e tyre dhe Kuvendit t’i paraqesin për votim tekstin e harmonizuar të mocionit.

Në lidhje me këtë çështje diskutuan edhe deputetët: Sabri Hamiti, kryeministri Hashim Thaçi, Visar Ymeri dhe Adem Grabovci, diskutimet e të cilëve janë dhënë të plota në transkript.

Pas kësaj kryetari caktoi një pushim prej 20 minutash, deri sa të bëhet harmonizimi i tekstit të mocionit, nga grupet parlamentare.

Pas pauzës kryetari ftoi deputetin Visar Ymeri për ta paraqitur tekstin e harmonizuar të mocionit.

Visar Ymeri tha se në bashkëpunim me GP të LDK-së dhe GP të AAK-së, e kemi modifikuar tekstin e mocionit i cili përbëhet prej dy pikave, si vijon:

1. Të pezullohet procesi i privatizimit kompanisë kosovare për distribuim dhe furnizim me energji elektrike derisa të dorëzohen informatat e plota në Kuvendin e Republikës së Kosovës në lidhje me këtë proces,
2. Vendimin përfundimtar për privatizimin e merr Kuvendi i Republikës së Kosovës.

Diskutimi i plotë i deputetit Visar Ymeri, është dhënë në transkript.

Kryetari, hodhi në votim, tekstin e harmonizuar të Mocionit të paraqitur nga deputeti Visar Ymeri.

Kryetari konstatoi se në sallë janë prezentë 80 deputetë.

Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për-----	31,
Kundër-----	48 ,
Abstenime-----	2.

Kryetari konstatoi se Kuvendi, me shumicë votash, mori këtë

V E N D I M

Kuvendi nuk e miratoi mocionin lidhur me procesin e privatizimit të Shpërndarjes dhe të Furnizimit të KEK-ut.

5. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për mbrojtjen e bimëve

Kryetari e ftoi përfaqësuesin e Qeverisë që para deputetëve të Kuvendit ta paraqesë dhe arsyetojë Projektligjin për mbrojtjen e bimëve.

Ministri **Blerand Stavileci** tha se arsyeja kryesore e propozimit të këtij Projektligji ka qenë harmonizimi më i mirë me legjislacionin e BE-së dhe me praktikat më të mira të saj.

Qëllimi kryesor i këtij projektligji është rregullimi i të gjitha aktiviteteve që kanë të bëjnë me mbrojtjen e bimëve, përcaktimin e masave për parandalimin e hyrjes dhe përhapjes së organizmave të dëmshëm në bimë, lehtësimin e mbledhjes dhe këmbimit të informatave me vendet e tjera, financimin dhe kompensimin për punët e kryera në fushën e mbrojtjes së bimëve dhe përcaktimin e detyrave dhe përgjegjësi të subjekteve të përfshira në mbrojtjen e bimëve dhe zbatimin e këtij ligji në Kosovë.

Më pas, ministri u fokusua në strukturën dhe përmbajtjen e projektligjit.

Në fund, ministri Stavileci i ftoi deputetët e Kuvendit që ta miratojnë në parim Projektligjin për mbrojtjen e bimëve.

Pastaj, kryetari e hapi debatin për shqyrtimin në parim të Projektligjit për mbrojtjen e bimëve.

Për këtë pikë të rendit të ditës diskutuan edhe deputetët: Sali Morina - në emër të Komisionit Funkcional për Bujqësi, Pylltari, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor, Nijazi Idrizi - në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, Afërdita Berisha-Shaqiri - në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, Visar Ymeri - në emër të Grupit Parlamentar të Lëvizjes “Vetëvendosje”, Time

Kadrijaj - në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, Myzejane Selmani - në emër të Grupit Parlamentar të Koalicionit Kosova e Re, ndërsa Albert Kinolli - në emër të Grupit Parlamentar “6+”, diskutimet e të cilëve janë dhënë të plota në transkript.

Pas këtyre diskutimeve, kryetari e hodhi në votim Projektligjin për mbrojtjen e bimëve.

Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për ----- 57,
Kundër ----- 0,
Abstenime ----- 0.

Kryetari konstatoi se Kuvendi e miratoi në parim Projektligjin për mbrojtjen e bimëve.

Kuvendi e ngarkoi Komisionin për Bujqësi, Pylltari, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor, si komision funksional dhe komisionet e përhershme që ta shqyrtojnë Projektligjin brenda dy muajve dhe Kuvendit t’ia paraqesin raportet me rekomandime.

6. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për regjistrimin e bujqësisë

Kryetari e ftoi përfaqësuesin e Qeverisë që para deputetëve të Kuvendit ta paraqesë dhe arsyetojë Projektligjin për regjistrimin e bujqësisë.

Ministri **Blerand Stavileci** tha se arsyeja e nxjerrjes së këtij Projektligji qëndron në avancimin e sektorit të bujqësisë, i cili është hartuar sipas standardeve dhe politikave më të avancuara për shoqërinë bashkëkohore dhe demokratike

Në vazhdim theksoi se ky Projektligj rregullon organizimin dhe regjistrimin e bujqësisë në vitin 2013, në tërë territorin e Republikës së Kosovës.

Qëllimi kryesor i këtij projektligji është adresimi i përgjegjësive dhe kompetencave të organeve të cilat organizojnë, ndihmojnë dhe kryejnë regjistrimin, përpunimin dhe ruajtjen e të dhënave që dalin si rezultat i regjistrimit, si dhe ruajtjen e fshehtësisë së të dhënave individuale të regjistrimit të bujqësisë.

Më pas, ministri u fokusua në strukturën dhe përmbajtjen e projektligjit.

Në fund, ministri Stavileci i ftoi deputetët e Kuvendit që ta miratojnë në parim Projektligjin për regjistrimin e bujqësisë.

Pastaj, kryetari e hapi debatin për shqyrtimin në parim të Projektligjit për regjistrimin e bujqësisë.

Për këtë pikë të rendit të ditës diskutuan edhe deputetët: Sali Morina - në emër të Komisionit Funksional për Bujqësi, Pylltari, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor dhe në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, Nijazi Idrizi - në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, Visar Ymeri - në emër të Grupit Parlamentar të Lëvizjes “Vetëvendosje”, Time Kadrijaj - në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, Myzejane Selmani - në emër të Grupit Parlamentar të Koalicionit Kosova e Re, diskutimet e të cilëve janë dhënë të plota në transkript.

Pas këtyre diskutimeve, kryetari e hodhi në votim Projektligjin për regjistrimin e bujqësisë.

Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për ----- 59,
Kundër ----- 0,
Abstenime ----- 0.

Kryetari konstatoi se Kuvendi e miratoi në parim Projektligjin për regjistrimin e bujqësisë.

Kuvendi e ngarkoi Komisionin për Bujqësi, Pylltari, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor, si komision funksional dhe komisionet e përhershme që ta shqyrtojnë Projektligjin brenda dy muajve dhe Kuvendit t'ia paraqesin raportet me rekomandime.

7. Shqyrtimi i Propozim-strategjisë Minerare të Republikës së Kosovës për periudhën 2012 – 2025

Kryetari ftoi përfaqësuesin e Qeverisë që para Kuvendit të ta paraqesë dhe arsyetojë Propozim-strategjinë Minerare të Republikës së Kosovës për periudhën 2012 – 2025.

Ministri **Besim Beqaj** tha se Propozim-strategjisë Minerare të Republikës së Kosovës për periudhën 2012 – 2025 është një dokument i Qeverisë që krijon mundësi reale për shfrytëzimin sa më racional dhe zhvillimin e qëndrueshëm të resurseve minerare, e cila do të kontribuojë në mirëqenien e të gjithë qytetarëve të vendit.

Propozim-strategjia është hartuar në bazë të vizionit ekonomik të Qeverisë së Kosovës, mbi bazën e parimeve themelore siç janë: miratimi i legjislacionit adekuat, forcimi i sektorit minerar, reforma strukturale ekonomike etj, theksoi ministri.

Më pas, ministri u fokusua në përbërjen dhe strukturën e kësaj strategjie, për të cilën tha se përbëhet prej katër shtyllave, si në vijim: shtylla e parë-krijimi i kushteve të favorshme për shfrytëzimin dhe valorizimin ekonomik të resurseve minerare dhe tërheqjen e investimeve, shtylla e dytë-rritja e kapaciteteve njerëzore dhe institucionale në sektorin minerar, shtylla e tretë-çështjet sociale dhe përfitimet e komunitetit dhe shtylla e katërt-përkujdesja për mjedisin. Ai më tej u bëri një vështrim më të hollësishëm të gjitha këtyre shtyllave të Propozim-strategjisë.

Në fund, ministri Beqaj i ftoi deputetët e Kuvendit që ta miratojnë Strategjinë Minerare të Republikës së Kosovës për periudhën 2012 – 2025.

Për këtë pikë të rendit të ditës diskutuan edhe deputetët: Zenun Pajaziti - në emër të Komisionit Funksional për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri, Sala Berisha-Shala – në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, Lutfi Zharku - në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, Visar Ymeri - në emër të Grupit Parlamentar të lëvizjes "Vetëvendosje", Ardian Gjini - në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, Myzejene Selmani - në emër të Grupit Parlamentar të Koalicionit Kosova e Re, ndërsa Fikrim Damka - në emër të Grupit Parlamentar "6+", diskutimet e të cilëve janë dhënë të plota në transkript.

Pas këtyre diskutimeve, kryetari hodhi në votim miratimin e Propozim-strategjinë për Minerare të Republikës së Kosovës për periudhën 2012 – 2025.

Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për----- 37,

- -

Kundër-----29,
Abstenime-----0.

Kryetari konstatoi se Kuvendi, me shumicë votash, mori këtë

V E N D I M

1. Kuvendi miratoi Strategjinë Minerare të Republikës së Kosovës për periudhën 2012-2025.
2. Strategjia Minerare e Republikës së Kosovës për periudhën 2012 – 2025, dërgohet për publikim në Gazetën Zyrtare.

8. Shqyrtimi i Rekomandimit të Komisionit për Mbikëqyrjen e Financave Publike lidhur me Raportin e auditimit të pasqyrave vjetore financiare të Organit Shqyrtues të Prokurimit Publik

Deputeti **Ali Sadriu**, në emër të Komisionit FunkSIONAL për Mbikëqyrjen e Financave Publike tha se, si komision, kemi shqyrtuar Raportin e auditimit të pasqyrave vjetore financiare të Organit Shqyrtues të Prokurimit Publik dhe kemi paraqitur rekomandimet nga ana e Komisionit FunkSIONAL, për miratim në mbledhje plenare.

Ai në vazhdim para deputetëve paraqiti dhe arsyetoi rekomandimin e Komisionit që ai drejton, që përbëhet prej tri pikave.

Për këtë pikë të rendit të ditës diskutuan edhe deputetët: Ramiz Lladrovci - në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, Ali Sadriu - në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, Afrim Hoti - në emër të Grupit Parlamentar të lëvizjes "Vetëvendosje", Ardian Gjini - në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, Muhamet Mustafa - në emër të Grupit Parlamentar të Koalicionit Kosova e Re, ndërsa Albert Kinolli - në emër të Grupit Parlamentar "6+" si dhe Hykmete Bajrami, diskutimet e të cilëve janë dhënë të plota në transkript.

Pas këtyre diskutimeve, kryetari hodhi në votim miratimin e Raportit të auditimit të pasqyrave vjetore financiare të Organit Shqyrtues të Prokurimit Publik.

Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për----- 50,
Kundër-----12,
Abstenime-----0.

Kryetari konstatoi se Kuvendi me shumicë votash mori këtë

V E N D I M

Miratohen Rekomandimet e Komisionit për Mbikëqyrjen e Financave Publike lidhur me Raportin e auditimit të pasqyrave vjetore financiare të Organit Shqyrtues të Prokurimit Publik.

9. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për shfuqizimin e neneve 37, 38 dhe 39 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës.

Kryetari e ftoi përfaqësuesin e Qeverisë që para deputetëve të Kuvendit ta paraqesë dhe arsyetojë Projektligjin për shfuqizimin e neneve 37, 38 dhe 39 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës.

Ministri **Besim Beqaj** tha se ky Projektligj ka për qëllim të bëjë shfuqizimin e neneve 37, 38 dhe 39 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës.

Në fund, ministri Beqaj i ftoi deputetët e Kuvendit që ta miratojnë në parim Projektligjin për shfuqizimin e neneve 37, 38 dhe 39 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës.

Pastaj, kryetari e hapi debatin për shqyrtimin në parim të Projektligjit për shfuqizimin e neneve 37, 38 dhe 39 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës.

Për këtë pikë të rendit të ditës diskutuan edhe deputetët: Arben Gashi - në emër të Komisionit Funkcional për Legjislacion, Adem Grabovci - në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, Ismet Beqiri - në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, Alma Lama - në emër të Grupit Parlamentar të Lëvizjes “Vetëvendosje”, Ardian Gjini - në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, ndërsa Myzejene Selmani - në emër të Grupit Parlamentar të Koalicionit Kosova e Re, diskutimet e të cilëve janë dhënë të plota në transkript.

Pas këtyre diskutimeve, kryetari e hodhi në votim Projektligjin për shfuqizimin e neneve 37, 38 dhe 39 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës.

Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për ----- 59,
Kundër ----- 0,
Abstenime ----- 2.

Kryetari konstatoi se Kuvendi e miratoi në parim Projektligjin për shfuqizimin e neneve 37, 38 dhe 39 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës.

Kuvendi e ngarkoi Komisionin për Legjislacion, si Komision Funkcional dhe Raportues, dhe komisionet e përhershme që ta shqyrtojnë Projektligjin brenda dy muajve dhe Kuvendit t’ia paraqesin raportet me rekomandime.

Kryetari deklaroi të mbyllur punimet e mbledhjes së sotme në orën 18:00 minuta.

Kryetari i Kuvendit

Jakup KRASNIQI